ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
SEKTORI I BUXHETIT DHE FINANCËS

Nr.2788 prot. Tiranë, më 24.09.2026

Lënda: Dërgohet raporti dhe anekset e monitorimit të buxhetit për 8 mujorin 2026.

MINISTRISË SË FINANCAVE
Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit

Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Nr.3, Tiranë

Në zbatim të Udhëzimit Plotësues të Ministrisë së Financave nr.2, dt.14.01.2026, "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2026", ju dërgojmë bashkëlidhur raportin dhe anekset e monitorimit të buxhetit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për periudhën janar – gusht 2026, plotësuar sipas kërkesave të Udhëzimit nr.14, datë 30.05.2023 "Për proçedurat standarde të monitorimit të buxhetit në Njësitë e Qeverisjes Qendrore".

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Dëshira Pasko

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË -

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË

Sektori i Buxhetit dhe Financës

RAPORTI

I MONITORIMIT TË BUXHETIT TË ZYRËS SË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË PËR 8 MUJORIN E VITIT 2026

Përmbajtja:

- Hyrje
- Informacion mbi performancën e programit buxhetor
- Aneksi nr.1 "Raporti përmbledhës i shpenzimeve të Ministrisë/ institucionit buxhetor"
- Aneksi nr.1.1 "Raporti i shpenzimeve të ministrisë/ institucionit buxhetor sipas kapitujve"
- Aneksi nr.1.2 "Shpenzimet buxhetore në total programi dhe total ministrie/ institucioni buxhetor sipas artikujve"
- Aneksi nr.2 "Raporti mbi ekzekutimin e buxhetit në nivelin e programit të buxhetit"
- Aneksi nr.2.1 "Shpenzimet e programit sipas kapitujve"

- Aneksi nr.3 "Raporti i performancës së produkteve të programit"

- Aneksi nr.3.1 "Raporti i performancës së produkteve të programit sipas artikujve"

- Aneksi nr.3.2 "Devijacioni i kostos për njësi në vite"

- Aneksi nr.4 "Raporti i realizimit të treguesve të performancës së programit"

HYRJE

Institucioni i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka realizuar monitorimin e buxhetit të vitit 2026 për periudhën janar- gusht 2026, përmes vlerësimit të performancës së fondeve buxhetore, si dhe krahasimit të nivelit faktik të treguesve të performancës me ato të planifikuar. Ky proçes ndiqet në vijimësi nga strukturat përgjegjëse, të cilat kanë kryer monitorimin e treguesve buxhetorë në funksion të vijimësisë së realizimit të objektivave dhe masave të planit strategjik dhe planit të veprimit të ILD-së për vitet 2026-2028.
Ky raport monitorimi pasqyron realizimin e fondeve buxhetore të ILD-së, të detajuar në nivel kategorie të shpenzimeve buxhetore, kundrejt treguesve të planifikuar, duke mundësuar në këtë mënyrë sigurimin e një informacioni orientues në drejtim të përmirësimit të planifikimit dhe menaxhimit të buxhetit.
Mbështetur në Ligjin nr. 87/2025 "Për buxhetin e vitit 2026", si dhe në zbatim të Udhëzimit nr.9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", të ndryshuar, Udhëzimit nr.14, datë 30.05.2023 "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në NJQQ", për periudhën janar-gusht 2026, performanca e realizimit të buxhetit të ILD – së paraqitet më poshtë.

Buxheti i miratuar dhe ndryshimet e pësuara gjatë 8 mujorit 2026:

Buxheti i Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë identifikohet me programin buxhetor " Veprimtaria e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë", kodi "03320".

Për veprimtarinë e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, me ligjin nr. 87/2025 "Për buxhetin e vitit 2026", u alokuan fondet buxhetore në vlerën **446,200 mijë lekë**, të detajuara në :

1. Shpenzime korrente në shumën 317,700 mijë lekë
2. Shpenzime kapitale në shumën 128,500 mijë lekë

Krahasuar me buxhetin fillestar të vitit 2025 të miratuar me ligjin 115/2024, në një total prej 354,600 mijë lekë, buxheti i këtij viti është me një rritje në masën 25.8 %, e konkretisht:

- për grupin e shpenzimeve korrente kemi një rritje në vlerën 14,800 mijë lekë, ose në masën 4.9 %, rritje e ardhur nga reflektimi në ligj i efekteve të ndryshimeve të miratuara në kuadrin ligjor për pagat e magjistratëve, punonjësve të administratës publike dhe punonjësve mbështetës.
- për grupin e shpenzimeve kapitale, buxheti i këtij viti është 76,800 mijë lekë, ose rreth 2.5 herë më i lartë kundrejt vitit paraardhës.

Gjatë periudhës së 8 mujorit, buxheti është shtuar në vlerën 300 mijë lekë me miratimin e detajimit të fondit të veçantë për vitin 2026.

Gjithashtu, gjatë periudhës raportuese, buxheti i ILD-së ka pësuar ndryshime brenda zërave të shpenzimeve korrente nëpërmjet 2 rialokimeve të miratuara, e konkretisht:

- Transferimi i fondit prej 2,455.8 mijë lekë nga art.600 në art.606, për pagesën e dëmshpërblimit për vjetërsi në shërbimin civil për një punonjës të liruar nga shërbimi civil në kuadër të ristrukturimit të institucionit.

- Transferimi i fondit prej 6,000 mijë lekë nga art. 600 në art.602, për mbulimin e shpenzimeve të vizitës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe trupës së inspektorëve në Washington D.C., Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në datat 26.09.2026-03.10.2026, fond i cili nuk ishte planifikuar në buxhetin e ILD për vitin 2026, zëri 602, për faktin se ky aktivitet nuk ishte parashikuar gjatë hartimit të kërkesave buxhetore në PBA 2026-2028.

Numri i punonjësve të miratuar në ligj është 101 punonjës, në përputhje me organikën e institucionit, të miratuar me Vendimin nr.28/2020 të Kuventit, të ndryshuar. Në mbyllje të 8 mujorit 2026, organika e institucionit është plotësuar me 82 punonjës, duke rezultuar me 19 vende të lira, nga të cilat: 3 vende në pozicionin "Këshilltar", 5 vende në pozicionin "Inspektor magjistrat", 5 vende për pozicionin "Inspektor jo magjistrat", 2 vende në pozicionin "Ndihmës inspektor", 2 vende në pozicionin "Drejtor Drejtorie", 1 vend "Përgjegjës sektori" dhe 1 "Specialist".

<u>Performanca financiare e programit buxhetor.</u>

Në mbyllje të periudhës raportuese, shpenzimet faktike të programit buxhetor "Veprimtaria e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë", janë në vlerën totale 185,025 mijë lekë, me një realizim prej 41.44% të buxhetit vjetor. Shpenzimet që i takojnë periudhës maj-gusht, janë me rritje në masën 123.8 %, në raport me periudhën janar-prill të këtij viti.

Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, dinamika e shpenzimeve faktike është si më poshtë:

Art.	Emërtimi	Shpenzime faktike 8- 2025 (000 lekë)	Shpenzime faktike 8 -2026 (000 lekë)	Ndryshimi në vlerë (000 lekë)	Ndryshimi në %
600	Paga	112,899	126,845	(+) 13,946	+12.3%
601	Sigurime	15,983	17,738	(+) 1, 755	+11%
602	Mallra shërbime	19,803	24,161	(+) 4,358	+22%
605	Transferta org.ndërk.	-	-	-	-
606	Transf.për individ.	192	2,611	(+) 2,419	(+)1260%

230	Kapitale të patrupëzuara	475	0	(-) 475	(-)100%
231	Kapitale të trupëzuara	691	13,670	(+) 12,979	(+)1878%
	TOTALI	**150,043**	**185,025**	**(+) 34,982**	**(+)23.3%**

I analizuar sipas grupeve të shpenzimeve buxhetore, realizimi për periudhën janar-gusht 2026, është si më poshtë:

"Shpenzimet për paga e sigurime" – (art.600-601) , ku përfshihen shpenzimet për paga e sigurime për personelin e organikës dhe për punonjësit me kontratë të përkohshme, janë në vlerën **144,583 mijë lekë,** me një realizim në masën 53% të buxhetit të rishikuar për këtë grup.

"Shpenzimet operative dhe të tjera korrente" – (art. 602-606), ku përfshihen shpenzimet për mallra e shërbime, pagesa e kuotizacionit vjetor për RESIJ (Rrjeti Europian i Shërbimeve të Inspektimit), pagesat nga fondi i veçantë, pagesa e dëmshpërblimit për vjetërsi në shërbimin civil për një punonjës të liruar nga shërbimi civil në kuadër të ristrukturimit të institucionit, si dhe pagesat për rimbursimin e shpenzimeve celulare të funksioneve të përfshira në VKM nr.673 dt.02.09.2020, të ndryshuar.
Shpenzimet faktike të këtij grupi për 8 mujorin janë në total **26,772 mijë lekë**, me realizim në masën 59 % të buxhetit të rishikuar. Ecuria e realizimit të këtij treguesi në nivel artikulli është sipas parashikimeve.

Shpenzimet faktike korrente (art.600-606) të lidhura me produktin "Inspektime të kryera dhe ankesa të trajtuara", kodi 96301AA, për 8 mujorin e vitit 2026 me një total prej 171,355 mijë lekë, janë me rritje prej 22,478 mijë lekë, ose me 15.1% në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit paraardhës dhe me një realizim në masën 53.89% të planit të buxhetit 2026.

"Shpenzimet për investime" (art. 231)

Me ligjin 87/2025, në dispozicion të ILD -së u miratua një buxhet prej **128,500 mijë lekë** për shpenzimet kapitale për vitin 2026.

Analizuar sipas projekteve të investimeve të miratuara, ecuria e realizimit është si më poshtë:

Projekti : "Ndërtimi i sistemit të Menaxhimit të Çështjeve dhe dokumenteve në Zyrën e ILD", kodi 25AC801, me fond 112,774 mijë lekë – në zbatim të VKM nr.972, datë 02.12.2020 "Për organizimin, funksionimin e përcaktimin e kompetencave të Qendrës së Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë", ky projekt u shqyrtua dhe u miratua nga Bordi Drejtues i QTI-së, me vendimin nr. 07, datë 21.07.2026.
Aktualisht, në këtë fazë të hartimit të këtij relacioni, pas përfundimit të shërbimit të përkthimit të materialit (projekt – preventivit) nga gjuha shqipe në gjuhën angleze nga përkthyes zyrtar, ka nisur procedura për prokurimin e fondit të miratuar në buxhetin e këtij viti për ndërtimin e sistemit.

Projekti: "Ndërtimi i dhomës së serverave", kodi 18AB203, fondi i planifikuar 12,171 mijë lekë – projekti është realizuar 100%.

"Pajisje zyre", kodi 18AB205, fondi i planifikuar 2,355 mijë lekë. Procedurat e prokurimit të zërave objekt prokurimi po vijojnë sipas parashikimeve në regjistrin e prokurimeve publike për vitin 2026. Për periudhën e raportimit, fondi është realizuar në vlerën 1,500 mijë lekë, ose në masën 63.7%.

"Pajisje informatike", kodi 18AB206, me fond 1,200 mijë lekë, po vijon procedura e prokurimit sipas parashikimeve në regjistrin e prokurimeve publike për vitin 2026.

Referuar treguesve buxhetorë të realizuar për 8 mujorin, si dhe mbështetur në kuadrin ligjor për prokurimet publike, parashikimi i realizimit të buxhetit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në mbyllje të vitit 2026 paraqitet si më poshtë:

Art.	Emërtimi	Plani vjetor (000/lekë)	Fakti 8 mujor (000/lekë)	Realizimi 8/M në %	Realizimi i pritshëm vjetor (000/lekë)	Realizimi i pritsh. në %
600	Paga	239,444	126,845	52.97	209,000	87.3
601	Sigurime	33,300	17,738	53.27	28,500	85.5
602	Shpenzime operative	41,400	24,161	58.36	39,800	96.1
605	Transferta për org.ndërkomb.	600	0	0	0	0
606	Transferta për individët	3,256	2,611	80.21	2,770	85
231	Ndërtimi i dhomës së serverave	12,171	12,170	100	12,170	100
231	Pajisje zyre	2,355	1,500	64	2,200	93.4
231	Pajisje informatike	1,200	0	0	1,200	100

231	Sistemi i menaxhimit të çështjeve në ILD	112,774	0	0	0	0
	TOTALI	**446,500**	**185,025**	**41.4**	**295,640**	**66.2**

Performanca jo-financiare e programit buxhetor

Për vitin 2026, me buxhetin e miratuar në ligjin 87/2025, të ndryshuar, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në cilësinë e autoritetit shtetëror përgjegjës për zhvillimin e hetimit disiplinor dhe nisjen e procedimit disiplinor ndaj magjistratëve vijon realizimin e *qëllimit të politikës së programit*, që është "garantimi i funksionimit të shtetit të së drejtës, pavarësinë e sistemit të drejtësisë si dhe rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi".

Në përmbushjen e *objektivit* të programit: *"Fuqizimi i veprimtarisë për matjen e performancës së subjekteve të hetimit disiplinor mbi cilësinë dhe efikasitetin e dhënies së drejtësisë sipas standardeve evropiane"*, ka ndikuar realizimi i treguesve të performancës, e konkretisht:

- ✓ Rritja e standardeve me qëllim zhvillimin e procesit të hetimit disiplinor në përputhje me parimet e ligjshmërisë e të procesit të rregullt ligjor sipas standardeve ndërkombëtare, përmes ndjekjes së aktiviteteve trajnuese, pjesëmarrjes aktive në forume profesionale dhe zhvillimin e vizitave studimore në inspektoratet homologe evropiane. Gjatë periudhës janar-gusht 2026, janë kryer 10 vizita studimore dhe takime me institucionet dhe org. ndërkombëtare, si dhe janë realizuar tema dhe nën-tema trajnimi, me pjesëmarrjen e rreth 60 nëpunësve (inspektorë, ndihmësinspektorë dhe nëpunës të tjerë civilë të administratës së Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë), të organizuara nga institucione si Shkolla e Magjistraturës, EU4Justice, Këshilli i Evropës, ASPA, CEPEJ dhe Qendra Holandeze e Trajnimit dhe Studimit për Gjyqësorin (SSR – MATRA). Trajnimet janë fokusuar në forcimin e njohurive juridike, procedurale dhe etike, në përputhje me standardet evropiane dhe praktikat më të mira ndërkombëtare. Tematikat kryesore kanë përfshirë drejtimin dhe administrimin e prokurorisë; pavarësinë procedurale dhe përgjegjësinë e prokurorit; procedurat penale (përfshirë padinë civile në procesin penal dhe sigurimin e provave); integritetin dhe etikën në sistemin e drejtësisë; rolin e jurisprudencës dhe unifikimin e praktikës gjyqësore; zhvillimin profesional dhe përdorimin e teknologjisë; parandalimin dhe trajtimin e konfliktit të interesit; si dhe hartimin e shkresave zyrtare në përputhje me standardet juridiko administrative. Në tërësi, këto trajnime kanë kontribuar në rritjen e cilësisë profesionale, forcimin e integritetit dhe përmirësimin e eficiencës së veprimtarisë inspektuese.
- ✓ Përfundimi për periudhën 01.01.2026-31.08.2026, i 5 inspektimeve tematike dhe institucionale, pjesë e planit të inspektimeve të vitit 2025, afati i të cilave u shty për 4 mujorin e parë të viti 2026, si dhe përfundimi i trajtimit të 1262 të ankesave.

Produkti ***"Inspektime të kryera & ankesa të trajtuara" – kodi 96301AA***

- *Inspektime të kryera*

Për periudhën 01.01.2026-31.08.2026, është miratuar plani i inspektimeve për vitin 2026, përmes vendimit nr. 44, datë 30.01.2026, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë "Për miratimin e planit të inspektimeve për vitin 2026". Në këtë plan janë miratuar:

- 9 inspektime (8 tematike dhe 1 institucional), të cilat kanë nisur dhe janë parashikuar të përfundojnë gjatë vitit 2026.
- 5 inspektime janë nga plani i vitit 2025, afati i të cilave u shty për 4 mujorin e parë të viti 2026. Për periudhën e raportimit janë gjithsej 14 inspektime.

Për sa më lart, rezultojnë:

- ✓ 9 inspektime në proces;
- ✓ 5 inspektime tematike dhe institucionale të përfunduara.

- *Ankesa të trajtuara*

Për periudhën 01.01.2026 – 31.08.2026, ankesat e trajtuara nga Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë sipas vendimmarrjeve, janë si vijon:

- ✓ 966 ankesa janë arkivuar pas shqyrtimit fillestar;
- ✓ 246 ankesa janë arkivuar pas procesit të verifikimit;
- ✓ 50 ankesa për të cilat është përfunduar hetimi disiplinor,

me një total prej 1262 ankesa të trajtuara.

Kosto faktike për njësi e produktit ***"Inspektime të kryera & ankesa të trajtuara" – kodi 96301AA*** për periudhën raportuese, është në vlerën 135,244.79 lekë, me një deviacion prej (-) 15,440.86 lekë, në krahasim me këtë tregues të raportuar në 8 mujorin e vitit 2025.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Dëshira Pasko

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

ANEKSI nr.1 Raporti Përmbledhës i Shpenzimeve të Ministrisë/Institucionit Buxhetor

Periudha e Raportimit 8-2026

në/

Emri i Grupit Veprimtaria e Mbikqyrjes dhe Rivlerësimit në sistemin e Drejtesisë		Kodi i grupit 63										
EMËRTIME		Shpenzimet e Ministrisë/Institucionit										
		Viti paraardhës 2025		Periudha raportuese		Periudha raportuese		Periudha raportuese	Periudha raportuese			
		Shpenzime Faktike	Struktura e shpenzimeve në %	Plani Fillestar Vjetor Viti 2026	Struktura e shpenzime ve në %	Plani Vjetor i Rishikuar Viti 2026	Struktura e shpenzime ve në %	Ndryshimi i planit vjetor	Shpenzime Faktike të Periudhës/Progresive	Struktura e shpenzime ve në %	Ndryshimi Vjetor (Plan - Fakt)	% realiz
		(1)	(2)	(3)	(4)	(5)	(6)	7 (5-3)	(8)	(9)	10 (5-8)	11 (
Shpenzimet sipas programeve buxhetore												
Kodi i Programit	Emërtimi											
03320	Veprimtaria e Zyres se Inspektorit te Larte te Drejtesise	247,817,172.50	100.00%	446,200,000.00	100.00%	446,500,000.00	100.00%	300,000.00	185,025,467.00	100%	261,474,533.00	41
	Totali i Shpenzimeve buxhetore te Ministrise (Kap 01,02,03,04,05,08,22)	**247,817,172.50**	**100.00%**	**446,200,000.00**	**100.00%**	**446,500,000.00**	**100.00%**	**300,000.00**	**185,025,467.00**	**100%**	**261,474,533.00**	**41**
	Shpenzime nga te Ardhurat Jashte limitit (Kap 06)	**0.00**	**0.00%**	**0.00**	**0.00%**	**0.00**	**0.00%**	0.00	**0.00**	**0%**	**0.00**	
	Totali Shpenzimeve te Ministrisë	**247,817,172.50**		**446,200,000.00**		**446,500,000.00**		**300,000.00**	**185,025,467.00**		**261,474,533.00**	**41**
Shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik												
Artikulli	Emërtimi											
600	Paga	171,257,545.00	76.32%	247,900,000.00	78.03%	239,444,200.00	75.30%	-8,455,800.00	126,844,627.00	74.02%	112,599,573.00	52
601	Sigurime Shoqërore	24,255,802.00	10.81%	33,300,000.00	10.48%	33,300,000.00	10.47%	0.00	17,738,561.00	10.35%	15,561,439.00	53
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	28,612,602.50	12.75%	35,400,000.00	11.14%	41,400,000.00	13.02%	6,000,000.00	24,160,642.00	14.10%	17,239,358.00	58
603	Subvencione	0.00	0.00%	0.00	0.00%	0.00	0.00%	0.00		0.00%	0.00	
604	Transferta Korente të Brendshme	0.00	0.00%	0.00	0.00%	0.00	0.00%	0.00		0.00%	0.00	
605	Transferta Korente të Huaja	0.00	0.00%	600,000.00	0.19%	600,000.00	0.19%	0.00		0.00%	600,000.00	
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	273,858.00	0.12%	500,000.00	0.16%	3,255,800.00	1.02%	2,755,800.00	2,611,324.00	1.52%	644,476.00	80
	Nen-Totali Shpenzime Korrente	**224,399,807.50**	**100.00%**	**317,700,000.00**	**100.00%**	**318,000,000.00**	**100.00%**	**300,000.00**	**171,355,154.00**	**100.00%**	**146,644,846.00**	**53**
230	Kapitale të Patrupëzuara	1,072,206.00	4.58%	0.00	0.00%	0.00	0.00%	0.00	0.00	0.00%	0.00	0
231	Kapitale të Trupëzuara	22,345,159.00	95.42%	128,500,000.00	100.00%	128,500,000.00	100.00%	0.00	13,670,313.00	100.00%	114,829,687.00	10
	Nen-Totali Shpenzime Kapitale me financim te brendshem	**23,417,365.00**	**100.00%**	**128,500,000.00**	**100.00%**	**128,500,000.00**	**100.00%**	**0.00**	**13,670,313.00**	**100.00%**	**114,829,687.00**	**10**
230	Kapitale të Patrupëzuara	0.00	0.00%	0.00	0.00%	0.00	0.00%	0.00	0.00	0.00%	0.00	
231	Kapitale të Trupëzuara	0.00	0.00%	0.00	0.00%	0.00	0.00%	0.00	0.00	0.00%	0.00	
	Nen-Totali Shpenzime Kapitale me financim te huaj	**0.00**	**0.00%**	**0.00**	**0.00%**	**0.00**	**0.00%**	**0.00**	**0.00**	**0.00%**	**0.00**	**0**
	Totali Shpenzime Kapitale	**23,417,365.00**	**100.00%**	**128,500,000.00**	**100.00%**	**128,500,000.00**	**100.00%**	**0.00**	**13,670,313.00**	**100.00%**	**114,829,687.00**	**10**
	Totali i Shpenz. Buxhetore te Ministrise/Institucionit Buxhetor	**247,817,172.50**	**100.00%**	**317,700,000.00**	**100.00%**	**446,500,000.00**	**100.00%**	**300,000.00**	**185,025,467.00**	**100.00%**	**261,474,533.00**	**41.**
	Shpenzime nga te Ardhurat Jashte limitit (Kap 06)	**0.00**		**0.00**		**0.00**		**0.00**	**0.00**		**0.00**	**0.**
	Totali (Korrente + Kapitale + Shpenz.nga te ardh.jashte limti	**247,817,172.50**		**446,200,000.00**		**446,500,000.00**		**300,000.00**	**185,025,467.00**		**261,474,533.00**	**41.**
Numri i punonjësve		**83**		**101**		**101**			**82**			

Sekretari i Përgjithshëm	Emri		DËSHIRA PASKO
	Firma		
	Data		23.09.2026

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË - INSP

ANEKSI 1.1 Raporti i Shpenzimeve të Ministrisë/Institucionit sipas kapitujve

Periudha e Raportimit 8-2026

Kodi i Ministrisë	Kodi i Kapitullit	Emërtimi i Kapitullit	Periudha raportuese	Buxheti	Artikujt buxhetore									
					230	231	600	601	602	603	604	605	606	
			Periodike /Vjetore		Shpenzime Kapitale të Patrupëzuara	Shpenzime Kapitale të Trupëzuara	Pagat	Kontrib.e Sigurimeve Shoqërore	Mallra dhe Shërbime	Subveci-net	Të Tjera Transfer. Korrente Brendshme	Transfer. Korrente të Huaja	Transferta për Buxhetet Familiare dhe Individët	
63	01	Nga Buxheti	2026	Plani fillestar	-	128,500,000.00	247,900,000.00	33,300,000.00	35,400,000.00	0	0	600,000.00	500,000.00	44
63	01	Nga Buxheti	2026	Plani i rishikuar	-	128,500,000.00	239,444,200.00	33,300,000.00	41,400,000.00	0	0	600,000.00	3,255,800.00	44
63	01	Nga Buxheti	2026	Fakti	-	13,670,313.00	126,844,627.00	17,738,561.00	24,160,642.00	0	0	-	2,611,324.00	18
63	01	Nga Buxheti	2026	Angazhime	-	-	-	-	8,006,642.00	0	0	-	-	
63		Total	2026	Plani fillestar	-	128,500,000.00	247,900,000.00	33,300,000.00	35,400,000.00	0	0	600,000.00	500,000.00	44
63		Total	2026	Plani i rishikuar	-	128,500,000.00	239,444,200.00	33,300,000.00	41,400,000.00	0	0	600,000.00	3,255,800.00	44
63		Total	2026	Fakti	-	-	-	-	-	0	0	-	-	
63		Total	2026	Angazhime	-	-	-	-	8,006,642.00	0	0	-	-	
63		Ndryshimi ne vlere absolute	2026		-	128,500,000.00	112,599,573.00	15,561,439.00	17,239,358.00	-	-	600,000.00	644,476.00	27
63		Realizimi ne %	2026		-	0.00%	52.97%	53.27%	58.36%	0.00%	0.00%	0.00%	80.21%	

Drejtuesi i Ekipit Menaxhues të Programit	Emri	SERI RAMA	Sekretari i Përgjithshëm	Emri	DËSHIRA PASKO
	Firma			Firma	
	Data	21.09.2026		Data	23.09.2026

REPUBLIKA E SHQIPËRISË INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Aneksi 1.2 "Shpenzimet Buxhetore në Total Programi dhe Total Ministrie/Institucioni Buxhetor"

Periudha e Raportimit 8-2026

Kodi i Ministrisë	Kodi i Programi	Emërtimi i Programit	Viti	Tipi i Buxhetit	Art. 230	Art. 231	Art. 600	Art. 601	Art. 602	Art. 605	Art. 606	[illegible]
63	03320	Veprimtaria e Inspektorit te Larte te Drejtesise	2026	Plani fillestar	-	128,500,000.00	247,900,000.00	33,300,000.00	35,400,000.00	600,000.00	500,000.00	446
63	03320	Veprimtaria e Inspektorit te Larte te Drejtesise	2026	Plani i rishikuar	-	128,500,000.00	239,444,200.00	33,300,000.00	41,400,000.00	600,000.00	3,255,800.00	446
63	03320	Veprimtaria e Inspektorit te Larte te Drejtesise	2026	Shpenzime faktike	-	13,670,313.00	126,844,627.00	17,738,561.00	24,160,642.00	-	2,611,324.00	185
63	03320	Veprimtaria e Inspektorit te Larte te Drejtesise	2026	Angazhime	-	-	-	-	8,006,642.00	-	-	8
63		Ndryshimi ne vlere absolute	2026		-	114,829,687.00	112,599,573.00	15,561,439.00	17,239,358.00	600,000.00	644,476.00	261
63		Realizimi ne %	2026		0.00%	10.64%	52.97%	53.27%	58.36%	0.00%	80.21%	
63		Total i Ministrisë/Institucionit	2026	Plani fillestar	-	128,500,000.00	247,900,000.00	33,300,000.00	35,400,000.00	600,000.00	500,000.00	446
63		Total i Ministrisë/Institucionit	2026	Plani i rishikuar	-	128,500,000.00	239,444,200.00	33,300,000.00	41,400,000.00	600,000.00	3,255,800.00	446
63		Total i Ministrisë/Institucionit	2026	Shpenzime faktike	-	13,670,313.00	126,844,627.00	17,738,561.00	24,160,642.00	-	2,611,324.00	185
63		Total i Ministrisë/Institucionit	2026	Angazhime	-	-	-	-	8,006,642.00	-	-	8
63		Numri i punonjesve në Total	2026	Plani fillestar								
63		Numri i punonjesve në Total	2026	Plani i rishikuar								
63		Numri i punonjesve në Total	2026	Numri faktik								

Drejtuesi i Ekipit Menaxhues të Programit	Emri	SERI RAMA	**Sekretari i Përgjithshëm**	Emri	DESHIRA PASKO
	Firma			Firma	
	Data	21.09.2026		Data	23.09.2026

REPUBLIKA E SHQIPËRISË · INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Periudha e Raportimit 8-2026

ANEKSI nr. 2 Raporti mbi Ekzekutimin e Buxhetit në nivelin e Programit të Buxhetit

Emri i Grupi	Veprimtaria e Mbikqyrjes dhe Rivlerësimit në sistemin e Drejtesisë	Kodi i grupit	63
Emri i programit	Veprimtaria e Inspektorit te Larte te Drejtesise	Kodi i programit	03320

EMËRTIME		Shpenzimet e Programit									
		Viti paraardhës 2025		Periudha raportuese		Periudha raportuese		Periudha raportuese	Periudha raportuese		Ndryshimi Vjetor (Plan - Fakt)
		Shpenzime Faktike	Struktura e shpenzimeve ne %	Plani Fillestar Vjetor Viti 2026	Struktura e shpenzimeve ne %	Plani Vjetor i Rishikuar Viti 2026	Struktura e shpenzimeve ne %	Ndryshimi i planit vjetor	Shpenzime Faktike te Periudhës/Progresive	Struktura e shpenzimeve ne %	
		(1)	(2)	(3)	(4)	(5)	(6)	7 (5-3)	(8)	(9)	10 (5-8)
	Shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik										
	Emërtimi										
600	Paga	171,257,545.00	76.32%	247,900,000.00	78.03%	239,444,200.00	75.30%	(8,455,800.00)	126,844,627.00	74.02%	112,599,573.00
601	Sigurime Shoqërore	24,255,802.00	10.81%	33,300,000.00	10.48%	33,300,000.00	10.47%	-	17,738,561.00	10.35%	15,561,439.00
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	28,612,602.50	12.75%	35,400,000.00	11.14%	41,400,000.00	13.02%	6,000,000.00	24,160,642.00	14.10%	17,239,358.00
603	Subvencione	0.00	0.00%	0.00	0.00%	0.00	0.00%	-		0.00%	-
604	Transferta Korente të Brendshme	0.00	0.00%	0.00	0.00%	0.00	0.00%	-		0.00%	-
605	Transferta Korente të Huaja	0.00	0.00%	600,000.00	0.19%	600,000.00	0.19%	-		0.00%	600,000.00
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	273,858.00	0.12%	500,000.00	0.16%	3,255,800.00	1.02%	2,755,800.00	2,611,324.00	1.52%	644,476.00
	Nëntotali Shpenzime Korente	**224,399,807.50**	**100.00%**	**317,700,000.00**	**100.00%**	**318,000,000.00**	**100.00%**	**300,000.00**	**171,355,154.00**	**100.00%**	**146,644,846.00**
230	Kapitale të Patrupëzuara	1,072,206.00	4.58%	0	0.00%	-	0.00%	-	0.00	0.00%	-
231	Kapitale të Trupëzuara	22,345,159.00	95.42%	128,500,000.00	100.00%	128,500,000.00	100.00%	-	13,670,313.00	0.00%	114,829,687.00
	Nëntotali Shpenzime Kapitale me financim të brendshëm	**23,417,365.00**	**100.00%**	**128,500,000.00**	**100.00%**	**128,500,000.00**	**100.00%**	**0.00**	**13,670,313.00**	**0.00%**	**114,829,687.00**
230	Kapitale të Patrupëzuara	0.00		0.00		0.00		0	0.00	0.00%	0.00
231	Kapitale të Trupëzuara	0.00		0.00		0.00		0	0.00	0.00%	0.00
	Nëntotali Shpenzime Kapitale me financim të huaj	**0.00**	**0.00%**	**0.00**	**0.00%**	**0.00**	**0.00%**	**0**	**0.00**	**0.00%**	**0.00**
	Totali i Shpenzimeve Kapitale	**23,417,365.00**	**100.00%**	**128,500,000.00**	**100.00%**	**128,500,000.00**	**100.00%**	**0.00**	**13,670,313.00**	**0.00%**	**114,829,687.00**
	Totali i Shpenzimeve Buxhetore të Programit	**247,817,172.50**	**100.00%**	**446,200,000.00**	**100.00%**	**446,500,000.00**	**100.00%**	**300,000.00**	**185,025,467.00**	**100.00%**	**261,474,533.00**
	Shpenzime Korente nga të Ardhurat Jashtë limitit (Kap 06)	**0.00**	**0.00%**		**0.00%**		**0.00%**		**0.00**		**0**
	Shpenzime Kapitale nga të Ardhurat Jashtë limitit (Kap 06)	**0.00**	**0.00%**		**0.00%**		**0.00%**		**0.00**		**0**
	Totali i Shpenzimeve të Programit	**247,817,172.50**	**100.00%**	**446,200,000.00**	**100.00%**	**446,500,000.00**	**100.00%**	**300,000.00**	**185,025,467.00**	**100.00%**	**261,474,533.00**
	Shpenzimet sipas produkteve të programit buxhetor										
Artikulli	Emërtimi										
	Totali i Shpenzime Korente	**224,399,807.50**	**90.55%**	**317,700,000.00**	**71.20%**	**318,000,000.00**	**71.22%**	**300,000.00**	**171,355,154.00**	**92.61%**	**146,644,846.00**
Kodi i produktit	Emertimi										
96301AA	Inspektime te kryera / Ankesa te trajtuara	224,399,807.50	100.00%	317,700,000.00	100.00%	318,000,000.00	100.00%	300,000.00	171,355,154.00	100.00%	146,644,846.00
	Totali Shpenzime për Investime	**23,417,365.00**	**9.45%**	**128,500,000.00**	**28.80%**	**128,500,000.00**	**28.78%**	**0.00**	**13,670,313.00**	**7.39%**	**114,829,687.00**
Kodi i produktit	Emertimi										
18AB205	Pajisje zyre	17,451,760.00	74.52%	2,355,000.00	1.83%	2,355,000.00	1.83%	0	1,500,000.00	10.97%	855,000.00
25AC801	Ndërtimi i sistemit të menaxhimit të çështjeve dhe dokumenteve	597,000.00	0.00%	112,774,000.00	0.00%	112,774,000.00	0.00%	0	0.00	0.00%	112,774,000.00
18AB206	Pajisje kompjuterike	993,399.00	0.00%	1,200,000.00	0.00%	1,200,000.00	0.00%	0	0.00	0.00%	1,200,000.00
I8AB203	Ndërtimi i dhomes së serverave	475,206.00	0.00%	12,171,000.00	0.00%	12,171,000.00	0.00%	0	12,170,313.00	89.03%	687.00
18AB204	Sistem i videokoferencave në sallën e mbledhjeve	3,900,000.00	0.00%	-	0.00%	-	0.00%	0	0.00	0.00%	-
	Nëntotali Shpenzime Kapitale me financim të brendshëm	**23,417,365.00**	**74.52%**	**128,500,000.00**	**1.83%**	**128,500,000.00**	**1.83%**	**0.00**	**13,670,313.00**	**100.00%**	**114,829,687.00**
Kodi i produktit	Emertimi										

	Nëntotali Shpenzime Kapitale me financim të huaj	**0.00**	**0.00%**	**0**	**0.00%**	**0**	**0.00%**	**0**	**0.00**	**0.00%**	**0**
